



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna / Municipality
Hani i Elezit



Nr. 12/ 4002 /2026

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave nr 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Public të OJQ-ve, neni 8, pika 3.2 dhe në Rregulloren e Komunës së Hanit të Elezit 01/NR /2821/2022 të datës 31.05.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, neni 22, Komuna Hani Elezit shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për anëtarë të komisionit për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve dhe individëve të pranuar sipas thirrjes publike të Komunës

Bazuar në rregulloren e MF nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Public të OJQ-ve neni 8 , paragrafi 3.2 që pjesë e çdo komisioni vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjes publike duhen të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim Komuna Hani Elezit fton të gjithë të interesuarit/at që të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit/es së Komisionit Vlerësues për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të sipas thirrjes publike të Komunës së Hanit të Elezit me Nr.12/3403/2026 të datës: 14.04.2026 të publikuar nga Komuna Hani i Elezit.

Të gjithë kandidatët/et të cilët/at nuk janë nën hetime apo ndonjë procedurë penale dhe që kanë përvojë në shoqëri civile me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e Kulturës Rinisë, Sporteve dhe OJQ tjera mund të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësi të:

Pozitat:

- Një përfaqësues nga OJQ-të
- Një përfaqësues në cilësinë e ekspertit

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të angazhuarit në Organizata jo-qeveritare aktive që veprojnë në komunën e Hanit të Elezit
- Ekspert të pavarur të cilët kanë përvojë pune që ndërlidhet në hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e Kulturës.Rinisë,Sportit dhe OJQ-ve tjera.

Kandidatët/et duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të kenë diplomë universistare,
- Të kenë përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e kulturës, rinisë sportit dhe OJQ-ve tjera,
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjajshme në administratë shtetërore.

Dokumentete e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Letër motivim nga OJQ me të cilën dëshmohet se aplikuesi është i angazhuar apo punësuar në organizatë;
- Diploma universitar;

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Hanit të Elezit Qendra për Shërbim të Qytetarëve çdo ditë pune nga ora: 08:00 deri 16:00.

Thirrja mbetet e hapur nga data 04.05.2026 deri 08.05.2026.

Një komision i themeluar nga Komuna do t'i vlerësojë të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët/et të cilët/at i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj thirrje publike që do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues për subvencionimin e OJQ-ve dhe individëve për vitin 2026.

Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

